

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË BURIMEVE**  
**NATYRORE**  
**DREJTORIA MINERARE DHE INDUSTRIALE**

---

**URDHËR**

Nr. 312, datë 13. 4. 2011

**PËR**  
**MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJ'** **DETYSUESHME QË PËRGATITEN NGA ZGJEDHJA** **INFORMACIONEVE TË**  
**T E LEJEVE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4, te Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 36, pika 23 dhe nenit 56, pika 2, të Ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë";

**URDHËROJ :**

1. Çdo zotërues i një leje minerare kërkim-zbulimi duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) informacionet e detyrueshme, sipas formatit, përcaktive të përmbajtjes dhe afatet e parashikuara në ligjin minerar Nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Këto informacione të detyrueshme janë:
  - a) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e programit minimal te punës, jo më vonë se 30 ( tridhjetë ) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes.
  - b) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet në çdo vit, jo më vonë se 30 ( tridhjetë ) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, për çdo vit në vazhdim.
  - c) Informacionet 3 (tremujore) mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor.
  - d) Informacionin vjetor, për veprimtarinë financiare dhe teknike te realizuar dhe të gjitha operacioneve të kryera në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin

vjetor të punës, duke përfshirë dhe te gjitha masat e marra për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i viti përkatës.

- e) Vlerësimin vjetor për vlerat e garancisë për zbatimin e programit minimal te punës dhe të garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet në çdo vit, jo më vonë se 30 ( tridhjetë ) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit në vazhdim për miratim.
  - f) Raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimitarise minerare duke dhënë në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë kërkimit- zbulimit, punimet e kryera në zonën e tij të lejuar (shoqëruar me vizatimet inxhinierike) dhe rezultatet e të gjitha provave të marra.
  - g) Raporti mbi pagesat për taksat vendore dhe kombëtare, në kuadër të Nismës për Transparency në Industrinë Nxjerrëse.
  - h) Informacionin për depozitim, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve.
  - i) Informacion për licencat, autorizimet apo lejet përkatëse, te marra nga zotëruesi i lejes nëse për kryerjen veprimitarise se tij, një veprimi apo për përdorimin e një të mire publike në zonën e lejuar, që, sipas lejes nuk është pjesë e të drejtave të zotëruesit të lejes minerare, kërkohet miratim paraprak nga organet shtetërore.
  - j) Te mbajë në zyrat e shoqërisë të gatshme për inspektim nga SHGJSH dhe t'i japë informacione dhe shpjegime kur këto kërkohen prej këtij institucionit.
2. Çdo zotërues i një leje minerare shfrytëzimi dhe/ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) informacionet e detyrueshme, sipas formatit, përcaktive të përbajtjes dhe afatet e parashikuara në ligjin minerar Nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim te tij. Këto informacione të detyrueshme janë:
- a) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e programit te investimit, jo më vonë se 30 ( tridhjetë ) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes.
  - b) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet çdo vit, jo më vonë se 30 ( tridhjetë ) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit në vazhdim.
  - c) Informacionet për pagesën e rentës minerare, sipas tipit të lejes minerare, në afatet e përcaktuara në legjislativën në fuqi për taksat dhe tatimet.
  - d) Informacionet 3 (tremujore) mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor.
  - e) Informacionin vjetor, për veprimitarinë financiare dhe teknike të realizuar dhe të gjitha operacioneve të kryera në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës, duke përfshirë dhe të gjitha masat e marra për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i viti përkatës.
  - f) Vlerësimin vjetor për vlerat e garancisë për zbatimin e planit të investimeve dhe të garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit në vazhdim për miratim.
  - g) Raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimitarise minerare duke dhënë në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë veprimitarise minerare, punimet e kryera në zonën e

tij të lejuar (shoqëruar me vizatimet inxhinierike) dhe rezultatet e planit te mbylljes, planit te rehabilitimit, planit te menaxhimit te mbetjeve dhe planit te monitorimit postminerar.

- h) Raporti mbi pagesat për taksat vendore dhe kombëtare, në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.
- i) Informacionin për depozitim, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve.
- j) Informacion për licencat, autorizimet apo lejet përkatëse, të marra nga zotëruesi i lejes nëse për kryerjen veprimtarisë se tij, një veprimi apo për përdorimin e një të mire publike në zonën e lejuar, që, sipas lejes nuk është pjesë e të drejtave të zotëruesit të lejes minerare, kërkohet miratim paraprak nga organet shtetërore.
- k) Te mbajë në zyrat e shoqërisë të gatshme për inspekrim nga SHGJSH dhe t'i japë informacione dhe shpjegime kur këto kërkohen prej këtij institucioni.

**MINISTRI**

**NASIP NAÇO**

